



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 537 / Prot.

Tiranë, më 15.04.2024

V E N D I M

Nr. 177 datë 04.04.2024

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 04.04.2024, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Albert Nikolla	Anëtar
Z. Gjergj Marku	Anëtar
Z. Skënder Vrioni	Anëtar



shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e udhëzuesit "Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person dhe formularit të aplikimit".

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 45/2015 "Për të drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, neni 8, 19, 20; Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 58 e vijues; Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", Ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligji nr.10/2023 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror të ndryshuar; Ligji nr. 9154/2003 "Për arkivat" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre, Udhëzuesi nr.6/2020 "Për politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individual", miratuar me si dhe Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit miratuar me vendim të Autoritetit nr.96, datë 12.02.2024, neni 8, neni 62.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbledhjen e Autoritetit datë 04.04.2024, nga DSHBF dhe DI, për shqyrtimin dhe trajtimin udhëzuesit për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person, për zbatimin e nenit 20, pika 1.1 të ligjit 45/2015, i ndryshuar,

V Ë R E N:

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar, përcakton se, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si institucion i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj.



Neni 7 i ligjit nr. 45/2015, parashikon se, Autoriteti e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij dhe kryen funksionet e tij, të përcaktuara në këtë ligj, në mënyrë kolegjiale. Autoriteti ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10 “Përgjegjësitë e Autoritetit”, 1. Autoriteti ka këto përgjegjësi:

a) grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj; b) vlerësimin, renditjen, evidentimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat; c) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të këtij ligji; ç) dhënien e informacioneve e të njoftimeve mbi dokumentet, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e tyre për kërkuesit; d) mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve; e) informimin e individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Hartimi i udhëzuesi “Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person, si dhe formularit të aplikimit”, është parashikuar si një domosdoshmëri për trajtimin e kërkesave nga çdo person në përputhje me ndryshimet ligjore që pësoi ligji organik në dispozita të veçanta të tij. Udhëzuesi sjell qartësim të dispozitës ligjore për kërkuesit në rastet e aplikimit pranë Autoritetit dhe trajtimit të kërkesës nga Autoritetit në zbatim të nenit 20, pika 1.1 të ligjit nr.45/2015, i ndryshuar.

Udhëzuesi ka si qëllim garantimin e zbatimit të ligjit 45/2015, i ndryshuar, neni 20, pika 1.1 përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave standard që duhet të ndiqen për trajtimin e kërkesave nga çdo person.

Udhëzuesi është në përputhje me ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit, si dhe aktet e tjera të brendshme. Për zbatimin e këtij udhëzuesi ngarkohet Drejtoria e Informacionit në varësinë e së cilës është Sektori i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese.

Udhëzuesi miratohet me aneksin nr. 1:

- Formulari i Aplikimi;
- Aneksi nr. 2 Procesverbali tip për dokumentimin e procesit lidhur me refuzimin e nënshkrimit nga kërkuesi të deklaratës së përgjegjësisë;

Deklarata a përgjegjësisë, si dhe njoftimi mbi miratimin e familjarit do të referohen sipas lidhjes nr.6 miratuar me rregulloren e Autoritetit me vendim nr.96, datë 12.02.2024 Dhe vendim të Autoritetit nr.598, datë 05.10.2023

Sa me sipër, Autoriteti vlerëson se udhëzuesi “Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person”, si dhe formularit të aplikimit janë hartuar përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar neni 20, si dhe Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, miratuar me vendim nr.96, datë 12.02.2024, Udhëzuesi nr.6/2020“Për politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individual”, si dhe aktet e tjera që normojnë veprimtarinë e Autoritetit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzuesit “Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person dhe formularit të aplikimit”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Dr. Gentiana Sula



ANËTAR

Altin Hoxha

ANËTAR

Dr. Albert Nikolla

ANËTAR

Gjergji Marku

ANËTAR

Skënder Vrioni